



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:295526

Datë: 10.11.2023

Numri i dokumentit: 04904864

C.nr. 2986/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtar Besnik Shala, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit A.G nga P të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve N & A” Sh.P.K. në P, kundër të paditurës B.K.S e cila përfaqësohet sipas autorizimit nga K.S.E e të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.A, baza juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit 356.20 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të dt. 30.10.2023, në prezencë të të autorizuarve të ndërgjyqësve, dhe me datë 10.11.2023 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.G nga P, ashtu që:

- I.** DETYROHET e paditura B.K.S, që paditësit A.G tija kompensoj dëmin material në murin dhe rrethojën e oborrit të shtëpisë së tij, gjegjërsisht në derën e oborrit e cila është konstrukcion metalik, nga aksidenti i komunikacionit rrugor i datës 30.09.2021, në shumë prej 356.20 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e parashtrimit të padis (30.12.2021) të gjitha këto brenda afatit 7 ditor, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.
- II.** **DETYROHET** e paditura B.K.S që paditësit A.G nga P, t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 632.20 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi në këtë gjykatë me dt. 30.12.2021, kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 356.20 euro,

E autorizuar e paditësi me padi gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: mbesim në tersi pran e padisë dhe kërkesës së saj, konsiderojmë se e paditura mbanë përgjegjësi për kompensimin e demit të shkaktuar ndaj paditësit i cili ka ndodhur me dt. 30.09.2021. duke u mbështetur e vendimin 70-24/2021 të dt. 24.09.2021, me të cilin KS Kosova e re i është revokuar licenca e siguruesit dhe ky vendim ka hyre në fuqi me dt. 25.09.2021. gjithashtu padia është parashtruar me dt. 24.12.2021, që d.m.t. kemi respektuar të gjitha afatet e

nevojshme për rastin e kërkimit të përgjegjës për demin e shkaktuar. Lartësia e kërkesëpadisë vërtetohet me ekspertizën e ndërtimtarisë e cila është punuar e dt. 16.12.2021, në procedurë jo kontestimore. I propozojmë gjykatës që duke u bazuar në fakte dhe prova materiale të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore dhe specifikuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës me përgjegje në padi, gjatës seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: mbetem në tërësi si në deklaratimet në kemi dorëzuar njoftimin e likuidatorit të kompanisë Kosova e Re, ku në pikën e fundit të këtij njoftimi thuhet se citojmë "dëshmia e dëmeve dhe pretendimeve kundër siguruesit Kosova e re, në likuidim të ndodhur me dt. 23.10.2021 e tutje duhet të dorëzohen në zyrën e BKS" ndërsa me këtë rast aksidenti ka ndodhur me dt. 30.09.2021 dhe se siç u cek me lartë BKS pranon kërkesa vetëm nga dt. 23.10.2021 e tutje, andaj me këtë vërtetohet se BKS nuk ka legjitimitet në këtë rast. Kërkojmë nga gjykata që padinë e paditësit ta refuzojë e tërësi si të pa bazuar në mungesë të legjitimitetit

Gjykata në këtë çështje juridiko kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: letërnjoftimi kopje për paditësin A.G, raporti fillestar i aksidentit me nr. 2021-DA-1735 i dt. 30.09.2021, procesverbali mbi vendëshiqimin e aksidentit me nr. 2021-DA-1735 i dt. 30.09.2021, 6 foto bardh-zi, ekspertiza nga lëmia e ndërtimtarisë e dt. 16.12.2021, certifikata e pronësisë për ngastrën kadastrale P-71611071-04320-23 në emër të A.G, vendimi nr. 70-24/2021 i lëshuar nga BQK, njoftimi me nr. Protokoli 1893 i dt. 07.12.2021 i lëshuar nga KS Kosova e Re, si dhe pati parasysh edhe deklaratimet e të autorizuarve të ndërgjyqësve të bëra gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tyre përfundimtare.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku e në lidhshmëri me njëra tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mesë palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 30.09.2021, kishte ndodhur aksidenti ku shkaktar i këtij aksidenti ishte ngasësi i veturës VW Pasat me targa të regjistrimit 03-481-EQ e i cili në kohën e aksidentit ishte i regjistruar tek KS Kosova e RE.

Në mesë palëve ndërgjyqëse ishte kontestues fakti se Kompania e Sigurimeve Kosova e Re i është revokuar licenca me vendimin nr. 70-24/2021 i datës 24.09.2021, të lëshuar nga BQK, ku pala e paditur pretendon se të paditurës BKS i mungon legjitimiteti pasi që me njoftimin për transferimin e portofolios 23.10.2021, të lëshuar nga KS Kosova e Re dhe nga kjo datë të njëjtës i takon që të merr përsipër obligimet.

Gjykata duke u bazuar në vendimin e BQK-së nr. 70-24/2021 i datës 24.09.2021, me anë të cilit i është revokuar Licenca KS Kosova e Re e i cili vendim ka hyrë në fuqi me datën 25.09.2021, andaj i njëjti ka prodhuar efekt nga kjo datë dhe aksidenti ka ndodhur me datë 30.09.2021, pra 6 ditë pasi që ka hyrë në fuqi ky vendim i BQK-së me nr. 70-24/2021, pra BKS

këtu e paditura ka për obligim nga kjo datë 25.09.2021, të i kompensoj të gjithë aksidentet që ndodhin pas marrjes së këtij vendimi t; cilët janë të siguruar tek KS Kosova e Re.

Gjykata duke u bazuar në nenin 136.1 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “ në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit” pra nga këto dispozita rrjedh se shkaktari dëmit këtu i siguruar tek KS Kosova e Re ka shkaktuar aksident dhe meqenëse të njëjtës i është revokuar licenca dhe këto obligime kanë kaluar te e paditura BKS e njëjta është e obliguar që të bëj kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 30.09.2021.

Për të vërtetuar lartasin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 30.09.2021, gjykata është bazuar në ekspertizën e ndërtimtarisë e nxjerrur në lenden CN.nr. 204/21 për sigurim prove ku në bazë të njëjtës dëmi i shkaktuar ka qen në lartësi prej 356.20 euro ku gjykata i fali besimin e plotë ekspertizës së datës 16.12.2021, pasi që e njëjta është në harmoni edhe me shkresat tjera të lendes.

Në bazë të nenit 169 par 1 i Ligjit Mbi Mardhenjet e Detyrimeve i cili ka përcaktuar se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi” ndërsa në paragrafin 4 parasheh “Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme” andaj duke u bazuar në ekspertizën e lartcekur në bazë të njëjtës është përcaktuar lartësia gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i pati parasysh kundërshtimet e të paditurës por të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe pasi që të njëjtat ishin vetëm të karakterit deklarativ e sipas nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, dhe me asnjë provë të vetme nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve të paditësit.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, dhe atë nga dita e marrjes së aktgjykimit pasi që pala e paditur nga ky moment bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, kreu XXVIII, Procedura në kontestet e vlerës së vogël, sqaron procedurën e kontesteve të vlerës së vogël në të cilat kërkesa nuk është më e madhe se 500 euro, dhe sipas dispozitës së nenit 491.1, 2,3 dhe 4 të LPK-së, parashihet së aktgjykimet dhe aktvendimet me të cilat përfundon procedura në kontestet të vlerës së vogël, mund të goditën vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave me rendësi esenciale të procedurës

kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar së drejtës materialë të cilat shkaqe për të cilat mund të goditet vendimi gjykata është e detyruar ti theksoj dhe se afati ligjor për goditjen e këtyre vendimeve dhe për përmbushjen e tyre është 7 ditor.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse në këtë procedurë, si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 632,20 euro, lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: (përpilimin e padisë shumë prej 78 euro, taksën për padi shumë prej 21 euro, për ekspertizën e ndërtimtarisë shumen prej 120 euro, për propozimin për sigurim prove 78 euro, për taks për sigurim prove 31 euro, për dy seanca të mbajtura për secilën nga $101.40 \times 2 = 202.80$ euro, dhe një seancë në procedurë për sigurim prove 101.40 euro).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1, të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:295526, 10.11.2023

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit se të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate, dhe vetëm për shkelje të dispozitave të ligjit për procedurën kontestimore dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.